

VENDIM
Nr. 472, datë 26.7.2023

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS SË
INOVACIONIT TË SIGURISË DHE MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin e Qendrës së Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes (në vijim “Qendra”), si person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit të Mbrojtjes (në vijim “ministri”), me seli në Tiranë.
2. Qendra financohet, pa u kufizuar, në burimet e mëposhtme:
 - a) buxheti i shtetit;
 - b) të ardhura të tjera të ligjshme në formën e granteve, donacioneve, projekteve të përbashkëta me aktorë të tjerë vendës apo të huaj, si dhe të ardhura të gjeneruara nëpërmjet ofrimit të shërbimeve për të tretë, sipas marrëveshjes përkatëse;
 - c) fonde nga persona fizikë e juridikë, publikë ose privatë.
3. Qendra ka për mision nxitjen e inovacionit dhe të të gjitha proceseve të lidhura me të nëpërmjet mbështetjes, monitorimit e vlerësimit të programeve, teknologjisë dhe projekteve që i përkasin fushës së sigurisë dhe mbrojtjes.

KREU II
PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË QENDRËS

1. Qendra ka këto përgjegjësi:
 - a) zhvillimin e iniciativave dhe projekteve inovative me rëndësi strategjike për zhvillimin e kapaciteteve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, sipas projekteve të përbashkëta dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me persona fizikë e juridikë, publikë ose privatë, si dhe partnerë të ndryshëm për zhvillim, vendës dhe ndërkombëtarë të kësaj fushe;
 - b) realizimin e testimeve dhe eksperimenteve për aplikimin e teknologjive të reja, produkteve industriale dhe shërbimeve me rëndësi strategjike, të përcaktuara për përdorim në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes dhe raporton për gjetjet tek autoritetet përkatëse;
 - ç) mbështetjen e kërkimit, zhvillimit, komercializimit që i avancojnë idetë e reja të sipërmarrjes në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, në faza të ndryshme zhvillimi përmes ofrimit të aksesit të mentorët, këshilltarët, trajnimet, kapitali dhe burimet;
 - d) ndërveprimin me ministrin përgjegjës për sipërmarrjen në masat, me qëllim mbështetjen dhe zhvillimin e ekosistemit të *startup*-eve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë;
 - dh) mbështetjen e të gjithë atyre individëve që dëshirojnë të eksplorojnë ose të ndjekin një rrugë sipërmarrëse që në fazat e hershme të atij procesi, në fushën e mbrojtjes civile, sigurisë kibernetike, sistemeve të sigurta që mbështesin institucionet e sigurisë kombëtare për integrimin e sistemeve etj.;
 - e) nxitjen e projekteve të paraqitura prej strukturave të Forcave të Armatosura, institucioneve të arsimit të lartë, personave fizikë dhe juridikë, vendës dhe ndërkombëtarë, që kanë për objekt të veprimtarisë inovacionin në fushat e shkencave natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane, që lidhen me fushën e sigurisë dhe mbrojtjes;

ë) dhënien e kontributit kryesor në nxitjen e inovacionit dhe rritjen e eficiencës në procese dhe mjete të Forcave të Armatosura, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe sistemit të sigurisë në tërësi;

f) dhënien e kontributit në rritjen e sigurisë kibernetike dhe performancës së sistemeve të Forcave të Armatosura, sipas standardeve të NATO-s;

g) dhënien e kontributit në përmirësimin nëpërmjet inovacionit të shërbimit të komunikimit, monitorimit, zbulimit apo planifikimit në strukturat e sigurisë në vend;

gj) dhënien e kontributit në fuqizimin e kapaciteteve të përpunimit dhe analizës së imazherisë satelitore, fotogrametrisë dhe gjeodezisë;

h) bashkëpunimin me ministritë dhe institucionet e tjera për zbatimin e strategjisë kombëtare sektoriale në fushën e shkencës dhe inovacionit, për sa i përket sigurisë dhe mbrojtjes;

i) nxitjen e bashkëpunimit me sektorin e biznesit në fushën e teknologjisë e inovacionit për sigurinë e mbrojtjes dhe mbështetjen ndaj iniciativave të tij në këtë fushë.

2. Për nevoja të realizimit të veprimtarisë së saj, Qendra shkëmben informacion me:

a) institucione në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes;

b) institucionet e arsimit të lartë, qendra dhe institucione kërkimore-shkencore në vend;

c) NATO-n dhe partnerë të tjerë për zhvillim;

ç) persona fizikë e juridikë, publikë ose privatë, vendës apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari në fushën e kërkimit shkencor, inovacionit, komunikimeve elektronike dhe teknologjisë së informacionit etj.;

d) ministrinë përgjegjëse për fushën e komunikimeve elektronike.

KREU III

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I QENDRËS

1. Qendra drejtohet nga drejtori, i cili është titullari i institucionit dhe përfaqëson Qendrën në marrëdhënie me të tretët. Drejtori ka këto kompetenca kryesore:

a) drejton, koordinon dhe monitoron veprimtarinë e Qendrës;

b) paraqet pranë ministrit, për miratim, aktet e brendshme që lidhen me veprimtarinë e Qendrës;

c) nënshkruan kontratat e financimit me aplikantët fitues, në kuadër të thirrjeve të hapura që realizohen nga Qendra. Përcaktimi i procedurave të thirrjeve të hapura dhe kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët do të përcaktohen me urdhër të ministrit të Mbrojtjes;

ç) bashkëpunon me agjencitë homologe në vende të tjera, nëpërmjet vendosjes së kontakteve, nënshkrimit të memorandumeve të mirëkuptimit për shkëmbim të eksperiencave dypalëshe;

d) informon ministrin e Mbrojtjes dhe bordin këshillimor për veprimtarinë e Qendrës, sa herë i kërkohet;

dh) i jep informacione, rekomandime e sugjerime Ministrisë së Mbrojtjes dhe institucioneve të tjera, lidhur me aspektet e politikave dhe strategjive sektoriale në fushën e inovacionit për sigurinë dhe mbrojtjen;

e) miraton raportin vjetor të veprimtarisë financiare të Qendrës;

ë) miraton programet zhvillimore të Qendrës;

f) i propozon ministrit projektbuxhetin dhe mënyrën e shpërndarjes e të administrimit të të ardhurave të Qendrës;

g) i propozon ministrit projektstrukturën organizative dhe përshkrimet e punës së stafit të Qendrës;

gj) i propozon ministrit fushat prioritare të teknologjisë dhe inovacionit për sigurinë dhe mbrojtjen, sipas sugjerimeve të bordit këshillimor.

2. Kompetencat e detajuara të drejtorit përcaktohen në rregulloren për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Qendrës.

3. Drejtori i Qendrës emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra nga ministri. Drejtori emërohet për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë riemërimi.

4. Drejtori për emërimin në detyrë duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të ketë diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional”, të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike ose të barasvlershme me to, sipas legjislacionit për arsimin e lartë për shkenca ekonomike/juridike/teknologji informacioni dhe komunikimi/inxhinieri elektronike/informatike/telekomunikacioni/matematikë-informatikë;
- ç) të ketë përvojë në profesion, të paktën 8 (tetë) vjet;
- d) të shquhet për figurë të pastër etiko-morale;
- dh) të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;
- e) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
- ë) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- f) të mos ketë konflikt interesi me detyrën në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesave.

5. Drejtori lirohet nga detyra, kur:

- a) plotëson moshën për pensionin e plotë të pleqërisë;
- b) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor;
- c) gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit;
- ç) jep dorëheqjen nga detyra;
- d) konstatohet performancë e dobët;
- dh) konstatohet në kushtet e ndalimit për kryerjen e funksioneve publike, sipas legjislacionit për integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

6. Drejtori shkarkohet nga detyra:

- a) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo të një kundërvajtjeje penale me dashje;
- b) kur me veprimet e kryera gjendet në një situatë të konfliktit të interesit;
- c) në rastet e mospërmbyshjes së rëndë të detyrave;
- ç) kur në mënyrë të përsëritur nuk respekton afatet e caktuara për përmbyshjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja shumë të rënda;
- d) në rastet e moszbatimit haptazi të dispozitave ligjore për përmbyshjen e detyrave funksionale;
- dh) kur braktis punën ose mungon në punë në mënyrë të pajustificuar dhe të vijueshme për 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune e më shumë.

7. Pranë Qendrës ngrihet bordi këshillimor, i cili funksionon sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe rregullores për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Qendrës.

8. Bordi këshillimor ka këto kompetenca kryesore:

- a) përcakton linjën kryesore të veprimtarisë së Qendrës;
- b) monitoron veprimtarinë ekonomiko-financiare të Qendrës;
- c) i propozon drejtorit fushat prioritare të teknologjisë dhe inovacionit për sigurinë dhe mbrojtjen.

9. Kompetencat e detajuara të bordit këshillimor përcaktohen në rregulloren për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Qendrës.

10. Bordi këshillimor përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë. Tre anëtarë përfaqësojnë Ministrinë e Mbrojtjes dhe institucionet e saj të varësisë dhe dy anëtarë të tjerë janë ekspertë nga sektori i biznesit, fusha akademike ose fusha të tjera që lidhen me veprimtarinë e Qendrës. Anëtarët e bordit këshillimor udhëhiqen nga parimi i mirëbesimit, duke përfshirë detyrimin për kujdesin, besnikërinë, konfidencialitetin, integritetin dhe pavarësinë, në raport me Qendrën.

11. Anëtarët e bordit këshillimor emërohen dhe shkarkohen nga ministri. Anëtarët e bordit këshillimor, të cilët nuk janë përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes dhe institucioneve të saj të

varësisë, duhet të kenë jo më pak se 5 (pesë) vjet eksperiencë pune në fushën e kërkimit-shkencor ose teknologjisë, ose inovacionit.

12. Anëtarët e bordit këshillimor emërohen për një mandat trevjeçar, me të drejtë riemërimi për një mandat të dytë radhazi.

13. Anëtarët e bordit këshillimor shkarkohen nga detyra, në rastet kur:

- a) veprojnë në kundërshtim me parimin e mirëbesimit;
- b) dënohen për kryerjen e një veprë penale me një vendim gjykate të formës së prerë;
- c) mungojnë në detyrë pa shkak për 3 (tri) mbledhje radhazi;
- ç) bëhen të paafte për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë për një periudhë mbi 6 (gjashtë) muaj.

14. Kryetari i bordit zgjidhet ndërmjet anëtarëve të bordit këshillimor, është një nga përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes dhe emërohet nga ministri.

15. Kryetari dhe anëtarët e bordit këshillimor të Qendrës, për çdo pjesëmarrje në mbledhje, shpërblehen nga buxheti i Qendrës, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësisë të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar.

16. Marrëdhëniet e punës së punonjësve civilë të Qendrës rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës, ndërsa marrëdhëniet e punës së personelit ushtarak të Qendrës rregullohen sipas legjislacionit në fuqi për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

17. Struktura dhe organika e Qendrës miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

18. Qendra funksionon sipas rregullores për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit, e cila propozohet nga drejtori dhe miratohet me urdhër të ministrit.

19. Qendra ka stemën, logon dhe vulën zyrtare. Stema e Qendrës përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Mbrojtjes, Qendra e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

20. Vula e Qendrës ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e përdorimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet e ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

1. Efektet financiare të këtij vendimi përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

2. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku